

VENDIM
Nr. 583, datë 18.10.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 473, DATË 1.8.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË
DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË
DREJTPËRDREJTË NË TND PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 27, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 473, datë 1.8.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2023”, togfjalëshi “...12 (dymbëdhjetë)...” zëvendësohet me “...18 (tetëmbëdhjetë)...”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku